

UDHËZIM
Nr.13, datë 26.5.2005

**PËR PROCEDURËN E ORGANIZIMIT TË SHORTIT, PËR SHPALLJEN E FITUESIT
MIDIS KANDIDATËVE QË KANË MARRË NUMËR TË BARABARTË VOTASH NË
ZONËN NJËMËRORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.5.2005, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 66 pika 2 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që zbatohen për organizimin e shortit, për shpalljen fitues të kandidatëve që marrin numër të barabartë votash në zonën njëmërore.

Neni 2

KQZ merr vendim për organizimin e shortit për zgjedhjen e kandidatit fitues, në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numër të barabartë votash në zonën njëmërore ku ata kandidojnë. Vendimi përmban vendin, datën dhe orën e zhvillimit të shortit.

Neni 3

Mbledhja për hedhjen e shortit organizohet në seancë publike, jo më herët se 5 ditë dhe jo më vonë se 7 ditë pas marrjes së vendimit për hedhjen e shortit.

Neni 4

Njoftimi për zhvillimin e shortit shpallet publikisht në hyrjen e selisë së KQZ-së, si dhe botohet në dy gazetat me tirazh më të madh.

Neni 5

1. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, sekretari i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e kandidatëve përkatës dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

2. Mosparaqitja e kandidatëve ose e njërit prej tyre nuk shtyn procedurat e shortit me përjashtim të rastit kur ndonjë prej tyre paraqet shkaqe të përligjura për mosparaqitjen. Në çdo rast shtyrja bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 48 orë.

3. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short.

4. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku në njërin prej tyre shënohet fjala

“FITUES”.

5. Radha e tërheqjes së goglave sipas pikës 3, caktohet me short.
6. Sekretari i KQZ-së fiton me radhë kandidatët për tërheqjen e shortit.

Neni 6

1. Kandidati që e hap goglën ia dorëzon sekretarit të KQZ-së, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në short.

2. Pasi është tërhequr gogla me shënimin “FITUES”, Sekretari i KQZ-së i hap me radhë goglat e mbetura në enë, nëse ka, lexon me zë të lartë përmbajtjen e fletëve dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 7

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KQZ me vendim shpall rezultatin e shortit duke deklaruar kandidatin fitues.

Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.